

Kujdestarët e fëmijëve (Children's Guardian)

Duke ndihmuar të arrijnë
rezultatet më të mira të
mundëshme për fëmijët që kanë
nevojë për mbikqyrje të siguruar.

Albanian

Çfarë është CAF/CASS?

Puna e Gjykatës Këshilluese për Fëmijët dhe Familjet e Shërbimeve Mbështetëse – CAF/CASS – është të mbrojnë¹ dhe të mbështesin mirëqënien e fëmijëve të përfshirë në procedurat gjyqësore familjare. Ne punojmë me fëmijët dhe familjet e tyre, duke bërë të sigurtë që zëri i fëmijëve të dëgjohet dhe nevojat e tyre të plotësohen.

Këshillojmë gjykatën që vendimet që ata marrin janë në interesat më të mira të fëmijëve. Ne jemi të pavarur nga gjykatat, shërbimet shoqërore², arsimi dhe autoritetet shëndetësore dhe gjithë agjensive të ngjashme. Ne punojmë vetëm në gjykata familjare. Këto nuk janë gjykata kriminale.

¹ Neni 2004 i Fëmijëve vendos statusin e përgjegjësisë në personat dhe agjensitë që punojnë me fëmijët për të mbrojtur dhe promovuar mirëqënien e fëmijëve, në veçanti, për të qënë të shëndetshëm, të sigurtë, të kënaqur dhe të sukseshëm, për të dhënë kontribut pozitiv dhe për të arritur mirëqënie të mirë ekonomike.

² Fjala 'Shërbime Shoqërore', në këtë fletushkë i referohet punës së autoriteteve lokale, që kanë marrë funksionin e shërbimeve shoqërore, dhe konkretisht kujdesin social të fëmijëve.

Çfarë është një Kujdestarë Femijësh?

Kujdestarët e fëmijëve janë të kualifikuar në punë shoqërore, të stërvitur dhe me eksperiencë për të punuar me fëmijët dhe familjet. Ata janë të caktuar nga gjykata të përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e fëmijëve në rastet që përfshijnë shërbimet shoqërore. Ata janë të pavarur nga shërbimet shoqërore, gjykatat dhe nga të gjithë të tjerët të përfshirë në çështjen gjyqësore. Kujdestarët e fëmijëve punojnë për CAF/CASS ose mund të jenë të vetë-punësuar dhe të kontraktuar nga ne.

Çfarë bëjnë Kujdestarët e Fëmijëve?

Kujdestarët e Fëmijëve janë të ndihmojnë të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme për fëmijët që prezantojnë. Në veçanti, ata:

- Caktojnë avokat për fëmijën, i cili specializohet për të punuar me fëmijët dhe familjet.
- Këshillojnë gjykatën rreth punës që duhet të bëhet para se gjykata merr vendimet e sajë.
- Shkruajnë raport për gjykatën, duke thënë çfarë ata mendojnë se ç'është më e mira për fëmijën. Raporti duhet t'i tregojë gjykatës rreth dëshirave dhe ndjenjave të fëmijës.

Për të bërë këtë, kujdestari i fëmijëve shpenzon kohë që të njohë fëmijët dhe anëtarët e familjeve të tyre. Ata bisedojnë me njerëz të tjerë që njohin familjen, si për shëmbull, të afërm, mësues, punëtorë social dhe punonjës shëndetësorë. Ata marrin pjesë në takime si përfaqësues të fëmijëve, kontrollojnë të dhënat dhe lexojnë raportet dhe deklaratat. Gjithashtu, ata mund të sugjerojnë që profesionistëve të tjerë j'u është kërkuar ndihmë, si për shëmbull peditër dhe psikolog.

A është konfidenciale ajo çfarë i them Kujdestarit të Fëmijëve?

Çdo informacion që i jepni Kujdestarit të fëmijëve mund të përfshihet në raportin për gjykatën dhe informacioni mund të përcillet për qëllime të tjera. Për shëmbull, ndonjëherë është e nevojshme të pasojnë informacion te një agjenci tjetër, nëse ka shqetësim për sigurinë e fëmijës. Si shtesë, jemi të autorizuar, të bëjmë kërkime shkencore për të mirën e fëmijëve dhe familjeve, dhe nga koha në kohë, informacioni juaj mund të përdoret anonimisht në një kërkim të tillë.

A rekomandon Kujdestari i Fëmijëve, gjithmonë, atë çfarë fëmija dëshiron?

Megjithëse, Kujdestarët e Fëmijëve, konsiderojnë gjithmonë dëshirat dhe ndjenjat e fëmijës dhe raportojnë në gjyq rreth kësaj, raporti i tyre do të paraqesë, gjithashtu, se çfarë ata mendojnë se ç'është më e mira. Kjo mund të mos jetë ajo çfarë fëmija mendon. .

A bën gjykata gjithmonë atë çfarë Kujdestari i Fëmijëve këshillon?

Është gjykata që vendos se çfarë do të ndodhë, por gjykata do të marrë në konsideratë me kujdes atë çfarë Kujdestari i Fëmijëve thotë. Nëse gjykata nuk është dakort me atë çfarë Kujdestari i Fëmijëve ka rekomanduar, do të shpjegojë pse.

A do t'a shoh raportin e Kujdestarit të fëmijëve?

Kujdestari i Fëmijëve normalisht do të diskutojë raportin e tyre me ju, para se t'a dërgojë në gjykatë. Kur dërgohet në gjykatë, ai është dëguar, gjithashtu, te avokati juaj nëse keni një, ose direkt te ju.

A konsiderohen mendimet e mia?

Mirëpresim vlerësime rreth shërbimeve dhe aktiviteteve, pasi kjo formon një pjesë të rëndësishme të zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve tona. Do të dëshironim të dëgjojmë nga të gjithë ata që përdorin shërbimet tona – fëmijë dhe të rinjë, prindër, të afërm, gjykatat dhe agjensi të tjera.

Vlerësimet mund të jenë:

- **Koment** rreth rregullave tona ose rregullores së punës ose rreth ndonjë aspekti tjetër të shërbimeve tona.
- **Kompliment** rreth punës tonë ose ndonjë Kujdestari Fëmijësh
- **Ankesë** rreth ndonjë aspekti të komunikimit me ne.

Do të rakordojmë, monitorojmë dhe rishikojmë të gjitha komentet, komplimentet dhe ankesat rreth shërbimeve tona dhe rezultatet do të publikohen në Raportin tonë vjetor.

Në interes të zhvillimit të shërbimit dhe për arsye të studimeve, mund t'ju pyesim për të marrë përshtypjet tuaja pas përfundimit të procedurave.

Si mund t'i jap komentet dhe komplimentet?

Transmeto çdo koment ose kompliment (preferuar me shkrim) te Kujdestari i Fëmijëve të interesuar ose dërgoju ato te manaxheri i CAF/CASS lokal, në adresën që ndodhet në faqen e fundit të kësaj fletushke. Mund t'i dërgoni komentet ose përshtypjet te zyra jonë nacionale nëpërmjet email-it yourviews@cafcass.gov.uk.

Në përfundim të çështjes tuaj ju mund të kërkonit takim për komente me Kujdestarin a Fëmijëve të përfshirë në çështjen tuaj ose me menaxherin e tyre.

Po sikur të mos jem i kënaqur me shërbimin që CAF/CASS jep?

Ne kemi për qëllim të japim standarte të larta të shërbimit në të gjitha procedurat familjare dhe t'ju japim t'ua dëgjojmë zërin fëmijëve në kohë kritike në jetën e tyre. Për ne është e rëndësishme të dimë kur përdoruesit e shërbimit besojnë se ne nuk i kemi realizuar qëllimet tona.

Ne kemi një proces për ankesat, që është projektuar të bëjë të sigurtë që ankesat janë marrë në konsideratë sa më shpejt, me ndërshmëri dhe efikasitet që të jetë e mundur. Një prezantim për procesin e ankesave mund të gjendet në faqen tjetër. Procesi i plotë është trajtuar në një broshurë për përdoruesit³ e shërbimeve, dhe është i disponueshëm nga zyra lokale e CAF/CASS, ose mund të merret nga seksioni *Information (Informacion)* në faqen tonë të internetit www.cafcass.gov.uk.

Po sikur të dua të ankojem?

Së pari, duhet që, gjithmonë, të njoftoni Kujdestarët e Fëmijëve të interesuar, nëse jeni i pakënaqur rreth ndonjë aspekti të shërbimit. Mund të jetë një mundësi për të sqaruar gjërat. Përndryshe, kërkoni takim për komente në përfundim të çështjes tuaj, siç u tha në faqen e përparshme.

Nëse nuk dëshironi t'a bëni këtë, por vendosni t'a bëni ankesën, atëherë, kontaktoni menaxherin lokal të CAF/CASS sa më shpejt të jetë e mundur, duke pasur parasysh afatin kohor në faqen tjetër, për të dërguar një ankesë.

Nëse nuk jeni dakort me përmbajtjen e raportit, zakonisht, më e mira është t'a ngrini këtë në ditën e gjyqit në gjykatë.

Nuk është e mundur të ndryshoni vendimin a gjykatës duke bërë ankesë te ne. Nëse nuk jeni dakort me vendimin e marrë nga gjykata duhet të merrni këshillë legale rreth mundësisë për të apeluar kundër vendimit të gjykatës.

Është e rëndësishme të vini re që ka kufinj Brenda të cilëve ne pranojmë ankesa. Për të rriturit kjo është brenda tre muajve të ngjarjes ose të ndodhjes

së incidentit. J'u lutemi referohuni te broshura *Your Views Count (Përshtypja juaj konsiderohet)* për detaje të plota të këtyre kufinjëve kohorë.

Mund të parashikoni faturë për marrjen e ankesës tuaj brenda pesë ditëve pune.

Ankesat nga fëmijët mund të merren në çdo kohë. Një fëmijë që dëshiron të bëjë ankesë do t'i ofrohet mbështetja e një avokati të pavarur përgjatë procesit.

Siguria e Fëmijës

Ne ndërmarrim kontrole me agjensi të tjera për të gjetur nëse fëmijët janë në rrezik për t'u dëmtuar rëndë. Kjo përfshin rastet kur fëmijët kanë parë violencë shtëpiake. Kontrole standarte janë ndërmarrë me policinë, shërbimet shoqërore dhe Regjistrin e Mbrojtjes së fëmijeve. Do t'ju njoftojmë nëse kontrole të mëtejshme janë kërkuar me agjensi shtesë (p.sh., GPs (Doktorë të Përgjithshëm), shkollat). Informacioni do të përdoret për parapërgaditjen e raportit për gjyq dhe, gjithashtu, mund t'i jepet shërbimeve shoqërore.

Larmia

Kemi për qëllim të marrim parasysh nevojat personale të fëmijëve dhe të respektojmë vlerat e komuniteteve të ndryshme, në të cilat ata rriten. Ne rakordojmë dhe monitorojmë informacion në lidhje me larminë e përdoruesve të shërbimit tonë – siç është origjina etnike, gjuha dhe nevojat speciale – për të n'a dhënë mundësi të përmirësojmë vazhdimisht kualitetin e shërbimit tonë për fëmijët dhe familjet e tyre. Gjithashtu, ky informacion n'a ndihmon të promovojmë barazi, siç është kërkuar në legjislacion përfshirë Race Relations Act 1976 (Akti 1976 i Marëdhënieve mes Racave) (I ndryshuar në

³ Your views count (Përshtypjet tuaja konsiderohen) – Si të bëni një koment, kompliment apo ankesë rreth punës tone.

2000 dhe 2003) dhe Disability Discrimination Acts 1995 and 2005 (Akti 1995 and 2000 i Diskriminimit të Paaftësisë

Informacion

Mënyra se si ne mbledhim, proçesojmë dhe bëjmë informacion të disponueshëm, drejtohet nga legjislacioni. Pikët e mëposhtme mund të jenë me interes për ju:

- Natyra e punës tonë kërkon proçesimin e informacionit personal në lidhje me përdoruesit e shërbimit tonë. Të gjitha aktivitetet e tilla janë ndërmarrë në linjë me Data Protection Act 1998 (Akti 1998 i Mbrojtjes së të Dhënave). Hyrja jonë në Regjistrin e Data Protection mund të gjendet në faqen e internetit: www.cafcass.gov.uk.
- Sipas Data Protection Act, j'u takon të pyesni për kopje të informacionit që ne mbajmë për ju.
- Jemi të dedikuar të japim informacion rreth shërbimeve tona në përputhje me Freedom of Information Act 2000 (Akti 2000 i Informacionit të Lirë).

Për më shumë detaje se si ne punojmë në linjë me Data Protection Act ose Freedom of Information Act, j'u lutemi vizitoni seksionin e *information (informacionit)* në faqen tonë të internetit www.cafcass.gov.uk ose kontaktoni zyrën tonë lokale të CAF/CASS.

Gjithashtu, faqja jonë e internetit përmban informacion të mëtejshëm rreth varietetit të plotë të shërbimeve tona.

www.cafcass.gov.uk

V3-05